

20151524357

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PRONËSI INDUSTRIALE**

Neni 1

Në Ligjin për pronësi industriale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 21/2009, 24/11, 12/14 dhe 41/14) në nenin 321 paragrafi (1) fjalia hyrëse ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 6.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, përkatësisht tregtarit individ, nëse:"

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së matur personit juridik përkatësisht tregtarit individ do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ, për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni."

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Përveç gjobës nga paragrafi (1) i këtij neni, personit juridik, përkatësisht individit tregtar i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar deri në tre vjet."

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Përveç gjobës nga paragrafi (2) i këtij neni, personit përgjegjës, përkatësisht personit juridik, përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ, i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje deri në një vjet." "

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 600 deri në 900 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni."

Paragrafi (6) ndryshohet si vijon:

"Përveç gjobës nga paragrafi (5) i këtij neni, personit fizik i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e profesionit ose veprimtarisë në kohëzgjatje deri në një vjet."

Paragrafi (7) ndryshohet si vijon:

"Për kundërvajtjet nga neni 318 i këtij ligji dhe paragrafi (1) i këtij neni, personit juridik, personit përgjegjës në personin juridik, personit përgjegjës në tregtarin individ dhe personit fizik do t'i shqiptohet sanksion i veçantë për heqjen e lëndëve."

Neni 2

Në nenin 322 paragrafi (1) fjalia hyrëse ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, përkatësisht tregtarit individ, nëse:"

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së matur personit juridik përkatësisht tregtarit individ do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ, për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni."

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 100 deri në 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni."

Neni 3

Pas nenit 322 shtohen tre nene të reja 322-a, 322-b dhe 322-v, si vijojnë:

"Neni 322-a

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 321 dhe 322 të këtij ligji, personit juridik, përkatësisht tregtarit individ, inspektori shtetëror i tregut para parashtrimit të kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje do të zbatojë procedurë për barazim me lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse.

(2) Kur inspektori shtetëror i tregut do të konstatojë kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni përpilon procesverbal në të cilin shënohen elementet e rëndësishme të kundërvajtjes, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e hasur aty për aty. Procesverbalin e nënshkruan personi i autorizuar zyrtar dhe kryerësi. Nëse kryerësi e pranon kundërvajtjen personi i autorizuar do t'i lëshojë urdhërpagesë kundërvajtëse për arkëtim të gjobës për kundërvajtje.

(3) Pas pranimit dhe nënshkrimit të urdhërpagesës për kundërvajtje, kryerësi i kundërvajtjes është i detyruar që ta paguajë gjobën e shqiptuar në afat prej tetë ditësh nga pranimi i urdhërpagesës për kundërvajtje në llogarinë e shënuar në urdhërpagesën.

(4) Kryerësi i kundërvajtjes i cili do të paguajë gjobën në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni do të paguajë gjysmën e gjobës së shqiptuar, për të cilën të drejtë këshillohet në këshillën juridike.

(5) Nëse kryerësi i kundërvajtjes nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni, inspektori shtetëror i tregut parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për kundërvajtjet nga neni 321 i këtij ligji, përkatësisht parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para Komisionit për Kundërvajtje të formuar në pajtim me Ligjin për inspektoratin shtetëror të tregut, për kundërvajtjet nga neni 322 të këtij ligji.

(6) Inspektorët shtetëror të tregut janë të detyruar që të mbajnë evidence për urdhërpagesat e lëshuara për kundërvajtje dhe për rezultatin e procedurave të ngritura.

(7) Në evidencën nga paragrafi (6) i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës për kundërvajtje që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

(8) Të dhënat personale nga paragrafi (7) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

(9) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje e përcakton ministri i Ekonomisë.

Neni 322-b

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 322 të këtij ligji, personit fizik, inspektorit shtetëror të tregut do t'i lëshohet urdhërpagesë mandatore, për pagesë të gjobës në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të urdhërpagesës mandatore ta paguajë gjobën në shumën e caktuar.

(2) Nëse personi fizik vullnetarisht nuk e paguan vullnetarisht në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni, ka fuqi të dokumentit përmbarues dhe inspektori shtetëror i tregut, do ta dorëzojë në organin kompetent për përmbarim të detyrueshëm, për përmbarimin e tij.

(3) Inspektorët shtetëror të tregut janë të detyruar që të mbajnë evidencë për urdhërpagesat e lëshuara mandatore dhe për rezultatin e procedurave të ngritura.

(4) Në evidencën nga paragrafi (3) i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës për kundërvajtje që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

(5) Të dhënat personale nga paragrafi (4) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

(6) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës mandatore për kundërvajtje e përcakton ministri i Ekonomisë.

Neni 322-v

Matja e lartësisë së gjobave të personit juridik, përkatësisht tregtarit individ, bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje."

Neni 4

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohet më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 5

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për pronësi industriale.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".